



# Ordinanza afariste / Qendra e fitnessit afarist

AAG – Analysis and Advisory Group



Ideja,  
strategjia,  
ekipi,  
konflikti,  
vendimi!





@Nicole Goggins



A keni ndonjëherë nevojë të bisedoni për **strategjinë tuaj afariste** me dikë që ka përvojë në biznes, që di të dëgjojë, dhe është delikat dhe i besueshëm?

A keni ndonjëherë nevojë ta vlerësoni ndonjë **ide tuaj** me dikë që ka kapacitet të kuptojë dhe të vlerësojë?

Ose ndoshta dy ose më shumë ide, por nuk dini **cilin drejtim strategjik ta zgjidhni?**


07.05.2010



A keni ndoshta probleme vijuese në punë dhe **duhet të ndërmerrni aksion**, por nuk dini prej ku të filloni?

A dëshironi ndonjëherë që ndonjë “sy i tretë” me përvojë të moderojë disa **mendime strategjike ose vijuese afariste të ekipit tuaj**?

A mendoni ndoshta që **ekipi nuk mund t’ju përcjellë në mendimet tuaja** dhe që më shpesh paraqitet disharmoni se sa njëzëshmëri?



A keni ndonjëherë nevojë për  
**qetësim të mosmarrëveshjeve** në  
ekip?

A keni nevojë për **ndihmë  
profesionale** në marrjen e ndonjë  
vendimi?

**A keni menduar** që në Maqedoni  
mund të merret një ndihmë e tillë  
profesionale?



◆ Analysis and  
■ Advisory  
■ Group

- Linden
- Zhvillohen
- Martohen
- Ndahen
- Lindin biznese (fëmijë) tjera
- I martojnë fëmijët e tyre
- Adoptojnë fëmijë të huaj

**Por edhe ...**

- Sëmuren
- Shkojnë në rehabilitim
- Disa edhe vdesin

## Bizneset janë të ngjashme me njerëzit!

Edhe ato, edhe pronarët dhe menaxherët e tyre, kanë nevojë për përkujdesje dhe ndihmë të kohëpaskohshme profesionale




◆ Analysis and  
■ Advisory  
■ Group

- Kujdesin për shëndetin dhe jetën e shëndoshë i konsiderojmë si kulturë themelore higjienike:
  - Rregullisht ta vizitojmë mjekun,
  - Të marrim ushqim të balancuar,
  - Të bëjmë ushtrime,
  - Të praktikojmë trajtime të caktuara të përkujdesjes dhe zbukurimit!

Në jetën private  
kujdesemi për shëndetin  
dhe kondicionin tonë

# Por...asnjëherë nuk jemi krejtësisht të kënaqur!

- Vazhdimisht krahasohemi me të tjerët – të afërmit ose idhujt!
- Nëse është kërcënuar vizioni ynë, të cilin e kemi paramenduar për vete – **NDËRMARRIM AKSION!**
- Pakënaqësia na nxit të synojmë të bëhemi më të mirë se vetvetja, por edhe se të tjerët, të arrijmë rezultate më të mira, t'i arrijmë **ËNDRRAT** tona!!!



# Kur bëhet fjalë për bizneset: Perceptimi ynë është i ndryshëm!



- E zhvillojmë biznesin dhe krenohemi me të, por nëse kohë pas kohe diçka nuk shkon aq mirë si që kemi menduar, përpiqemi mos ta pranojmë këtë, më gjatë se që është e shëndoshë dhe e nevojshme!
- Kurse edhe ai ka nevojë për përkujdesje, njëjtë si ne!

# A ka nevojë edhe biznesi juaj për përkujdesje plotësuese?



- A lëngon edhe biznesi juaj prej simptomave në shikim të parë të thjeshta, por të cilat, nëse nuk mjekohen, mund të jenë vdekjeprurëse?
- A zhvillohet mirë biznesi juaj, por ka nevojë për ushtrim, terapi të fitnesit?

# Qarkullimi i dobët dhe metabolizmi i dobët?

- Të hyrat e pamjaftueshme
- Rrjedhat e dobëta të parave të gatshme



# Tretja e dobët?

- Rezervat e mëdha
- Kërkesat e mëdha prej blerësve
- Obligimet e mëdha ndaj furnizuesve



@Violentz

# Pesha e tepërt?



- Shpenzimet e mëdha dhe jo gjithmonë të arsyeshme
- Niveli tepër i lartë i borxhit

@.Clo.

# Dezorientimi, apatia



- Mungesa e vizionit
- Strategjia e paqartë

# Mungesa e vëmendjes

- Qëllimet e pafokusuara
- Shpërqendrimi i aktiviteteve



# Paranoja?

- Mosbesimi në ekip
- Perceptimi i keq për problemet



@riplemdk

Pse njerëzit e biznesit  
reagojnë më ngadalë  
ndaj problemeve?



- Edhe bizneset mund të  
lëngojnë ose të kenë  
nevojë për fitnes!

# Pse njerëzit e biznesit reagojnë më ngadalë ndaj problemeve?

- Nuk dëshirojnë të pranojnë që kanë problem.
  - “Denial ain't just a river in Egypt.”

Mark Twain

shkrimtar amerikan




# Mundem vetë!

- **Simptomat:** Refuzimi i ofertave për përkrahje, tërheqja prej të tjerëve, mos-bisedimi për problemet dhe brengosjen, mos-inkuadrimi i të tjerëve në vendimmarrje.
- **Pse është e dëmshme kjo?** Vet-izolimi dhe përpjekja që në mënyrë të pavarur ta mbani barrën shkakton brengosje dhe pasiguri te të tjerët. Është e mundshme të përhapen thashetheme dhe njerëzit të shqetësohen.
- **Çka duhet të bëhet?** Bisedoni me të tjerët për atë se si mendoni t'i zgjidhni problemet. Bëjuani me dije të tjerëve që dëshironi të punoni në partneritet dhe që ju nevojitet përkrahja e tyre.
- **Angazhoni profesionistë që t'i moderoni mendimet e ndryshme.**



# Di çdo gjë!

- **Simptomat:** Keni përgjigje për çdo gjë; keni pikëpamje rigjide, jofleksibile për gjërat; nuk dëshironi të dëgjoni; i nënçmoni të tjerët dhe atë që e thonë ata; fjaloseni me njerëzit të cilët nuk pajtohen me ju; mendoni që perceptimi juaj për zgjidhjen është perceptimi i vetëm i saktë.
- **Pse është e dëmshme kjo?** Të tjerët ndjehen të pavlefshëm, të hidhëruar dhe të parëndësishëm. Humbet inovacioni dhe kreativiteti në ekip.
- **Çka duhet të bëhet?** Përpiquni të dalloni që keni problem të mungesës së kritikës në vlerësimin e plotfuqishmërisë së perceptimit tuaj. Lejoni kënde tjera të vështrimit të gjërave që ato të mund të bëhen më të qarta.
- **Angazhoni profesionistë që t'i moderoni mendimet e ndryshme.**



# Toleroni gjendje: "Nuk është keq"?

- **Simptomat:** Nuk ia dilni që ta parashikoni dhe me kohë të reagoni ndaj ndryshimit që vjen, me çka e mbani status quo-n ose bëni vetëm ndryshime të vogla. Nuk hulumtoni, kënaqeni me pak, nuk pranoni ide të reja dhe reagoni ndaj ndryshimeve atëherë kur vijnë, në vend se të jeni proaktivë.
- **Pse është e dëmshme kjo?** Të tjerët janë të dëshpëruar që ekipi udhëheqës nuk synon drejt përsosurisë dhe e humbin entuziazmin. Nuk është mirë të kënaqeni me nivelin e dytë: njerëzit të cilët punojnë për ju dëshirojnë të luajnë në ekipin fitimtar.
- **Çka duhet të bëhet?** Zbuloni çka ju mban prapa: bisedoni dhe njihuni me frenat. Inspirojeni ekipin që të synojë drejt përsosurisë.
- **Praktikoni fitnes afarist! Bëni trajnime, edhe më mirë me trajner!**



# Ordinanza afariste Fitnesi afarist



- Nuk dinit që edhe për bizneset ka “ordinanca” dhe “qendra të fitnesit”?
- Keni frikë që do t’ju kërcënohet besueshmëria.

# A keni ditur që ekziston shërbimi i ordinancës afariste dhe fitnessit afarist në tregun e Maqedonisë?

- Urdhëroni, njihuni me shërbimin tonë të ri:
- Për një kohë më të gjatë, AAG – Analysis and Advisory Group dhe partnerët e tij në mënyrë të pastrukturuar merren me këshillim i cili i takon këtij grupi të shërbimeve.
- Tani AAG lanson një prodhim të ri të quajtur **ORDINANCA AFARISTE dhe/ose QENDRA E FITNESSIT AFARIST!**



# Keni frikë se a janë të besueshëm profesionistët dhe a dinë mjaft

- AAG kultivon profesionalizëm, ekspertizë dhe raport të besueshmërisë së plotë ndaj klientëve të vet.
- Ekipi i AAG-së, i udhëhequr nga biznes-guruja maqedonase Verica Haxhi Vasileva-Markovska, është treguar i përgjegjshëm ndaj klientëve të tij në raste në të cilat u janë besuar çështjet dhe problemet më delikate dhe më të besueshme.
- Verica ka përvojë më shumë se 30-vjeçare në të gjitha sferat më të rëndësishme të ekonomisë së Maqedonisë:
  - Shkenca dhe hulumtimi
  - Sektori shtetëror
  - Kompani ndërkombëtare – një prej 4 ndërmarrjeve më të mëdha në botë të cilat ofrojnë shërbime profesionale
  - Sektori privat, partnere në ndërmarrjen e vet.
- Për vete dhe për ekipin e saj kultivon reputacion të diturisë, orientimit drejt klientëve, besueshmërisë së rreptë dhe aftësisë të ballafaqohen me detyra delikate.

# Çka mund të ofrojmë?

- Diagnozë fillestare sipërfaqësore të problemeve të cilat kanë prioritet për zgjidhje.
- Orientim të drejtimeve të mundshme të zgjidhjes
- Pjesëmarrje në sesion të “stuhisë së ideve”, ose në ndonjë takim tjetër të strukturuar të njerëzve kyçë, për zgjidhje të ndonjë problemi konkret
- Pjesëmarrje në sesion të “stuhisë së ideve” të të menduarit strategjik
- Ndhmë në implementimin e planit / planit aksionar/ strategjisë
- Prodhim special: mentorim (coaching) i pozitive kyçe udhëheqëse, duke e përfshirë edhe drejtorin kryesor ekzekutiv, në kryerjen e detyrave të caktuara ose në zbatimin e një pjese të planit.

# Prodhimet e Ordinancës afariste

Prodhimet e Qendrës së fitnessit afarist



# Çka mund të ofrojë Ordinanca afariste / Qendra e fitnessit afarist?

- Diagnozë dhe orientim
- Këshillim strategjik
- Terapi
- Intervenime konkrete
- Mentorim (coaching)



# Diagnoza dhe orientimi

- E analizojmë gjendjen
- Sigurojmë diagnozë fillestare sipërfaqësore të problemeve të cilat kanë prioritet për zgjidhje.
- I orientojmë drejtimet e mundshme të marrjes së vendimeve dhe të intervenimit eventual.




# Këshillimi strategjik

- Marrim pjesë në sesion të “stuhisë së ideve” të të menduarit strategjik
  - A ekzistojnë probleme në realizimin e vizionit, nëse ekziston ai?
  - A jeni të sigurt që keni vizion të njohur mirë të shoqërisë? A është ai i formuluar qartë?
  - A dini në cilin biznes funksiononi? Sado që të duket e qartë kjo, përgjigjja e kësaj pyetjeje mund ta ndryshojë konsiderueshëm shikimin tuaj ndaj punës suaj!
  - A mbani baraspeshë të mirë mes afatit të gjatë dhe të shkurtër?
  - Cilat janë problemet të cilat e pengojnë realizimin e vizionit?
    - Ju ndihmojmë të shihni më larg se simptomat!
    - Ofrojmë kombinim të intuitës dhe analizës.
  - Ju orientojmë që më lehtë të hyni në “këpucët” e klientit!

# Këshillimi strategjik (vazhdim)

- Marrim pjesë në sesion të “stuhisë së ideve”, ose në ndonjë takim tjetër të strukturuar të njerëzve kyçë, për zgjidhje të ndonjë problemi konkret, për marrje të ndonjë vendimi konkret kyç
- Mund të ndihmojmë në harmonizimin e qëndrimeve të njerëzve kyçë në organizatë, veçanërisht nëse ekziston problemi i dallimeve të kuptimeve dhe sjelljeve të cilat e vështirësojnë marrjen e vendimeve. Sigurojmë “Sy të tretë të pavarur dhe me përvojë”.
- Këtë e konsiderojmë si vegël më të rëndësishme të përkrahjes. Mund të zgjasë prej disa orëve deri në 2-3 ditë.
- Ndhmojmë në identifikimin e gjendjes së dëshiruar – indikatorët e rezultatit
- Përpiqemi t’i kuptojmë rrethanat pse është e tillë gjendja – mbajmë punëtori dhe realizojmë biseda me njerëzit kyçë
- Definojmë plan aksionar për tejkalim të problemeve, për realizim të indikatorëve

# Terapia



# Intervenimet konkrete

- Analiza e thellë
  - Financiare
  - Juridike
  - E resurseve njerëzore
- Vlerësimi i strategjive alternative afariste ose i drejtimeve alternative strategjike dhe ndihma gjatë zgjedhjes së atij më të vlefshëm
- Vlerësimi i vlerës së shoqërisë
- Hartimi i memorandumit informativ të shoqërisë me qëllim që të prezantohet para partnerëve afaristë ose para partnerëve me të cilët dëshirohet të realizohet lidhshmëri pronësore
- Ndihma gjatë gjetjes së partnerit për shitje ose blerje të ndërmarrjes
- Ndihma gjatë transaksioneve të blerjes ose shitjes së ndërmarrjes
- Ndihma gjatë krijimit dhe zbatimit të sistemit të menaxhimit të rezultatit
- Ndihma gjatë vendosjes së sistemit të burimeve njerëzore në bazë të shëndoshë
- Ndihma gjatë ndarjes së ndërmarrjeve
- Ndihma gjatë bashkimit, veçimit ose bashkëngjitjes së ndërmarrjeve



# Mentorimi (coaching)

- Prodhim i posaçëm: mentorimi (coaching) i pozitive kyçe udhëheqëse, duke e përfshirë edhe drejtorin kryesor ekzekutiv, në kryerjen e detyrave të caktuara ose në realizimin e një pjese të planit.
- Mentorimi mund të definohet me kohë, derisa një pozitë e caktuar të vendoset në një pozitë të caktuar, ose me arritje të ndonjë rezultati të caktuar, të definuar paraprakisht.

# Kontakti

## Ju faleminderit për vëmendjen!



**Analysis and Advisory Group d.o.o.**

Petar Pop Arsov, 8/1

1000 Shkup

Republika e Maqedonisë

**T:** +389-2-3246-431

**F:** T: +389-2-3246-422

**E:** [aag@aag.com.mk](mailto:aag@aag.com.mk)

**W:** [www.aag.com.mk](http://www.aag.com.mk)